

Kontrata e Sjelljes së Nxënësit (Klasat 6-12)

Emri i nxënësit	Datëlindja	Klasa
-----------------	------------	-------

E kam të qartë se është e drejta ime:

- të gjendem në një mjedis mësimor të sigurt dhe inkurajues, të lirë nga diskriminimi, ngacmimi dhe fanatizmi;
- të di si duhet të sillem dhe cilat sjellje mund të bëhen shkas për masa disiplinore;
- të këshillohem nga anëtarët e trupit pedagogjik për çështje që kanë të bëjnë me sjelljen time dhe ndikimin e saj në ecurinë time në shkollë;
- të mbrohem sipas ligjit në rast se merren masa disiplinore kundër meje për thyerje të rregullave të shkollës, për të cilat mund të pezullohem ose të dëbohem nga klasa.

Pranoj:

- të vij në shkollë në orar;
- të jem në orar për të gjitha orët e mësimor, i gatshëm për të filluar punë;
- të jem i përgatitur me materialet e duhura dhe detyrat që më janë ngarkuar për të gjitha orët e mësimor;
- të tregoj respekt për të gjithë kolektivin e shkollës;
- t'i zgjidh konfliktet në mënyrë paqësore dhe t'u shmangem zënieve brenda ose jashtë shkollës, ose në vende ku zhvillohet programi mësimor;
- të sillem me respekt, pa kundërshtuar, dhe të bashkëpunoj sa herë që një anëtar i trupit pedagogjik më jep një udhëzim ose më bën një kërkesë. E kam të qartë se do të më jepet mundësia t'i shpreh shqetësimet e mia në një kohë të përshtatshme, në qoftë se nuk pajtohem me kërkesën;
- të kujdesem me përgjegjësi për sendet e mia personale dhe të respektoj sendet personale të të tjerëve;
- të vishem në mënyrë të përshtatshme dhe të mos përdor veshje provokuese, të tilla si bluza tip kanotiere me rripa të hollë, veshje që e lënë barkun zbuluar, pantallona shumë të shkurtra ose minifunde;
- të mos mbaj shenja të përkatësisë në banda (të tilla si shami ose rripa koke) dhe të mos përdor shenja, pasthirrma, parulla, lëvizje, dhe shtrëngime duarsh të bandave;
- të mos sjell në mjediset e shkollës armë, droga të paligjshme, substanca të kontrolluara dhe alkool;
- të mos sjell në shkollë sende vetjake që prishin rregullin (p.sh. telefon celular, biper, peixher);
- të njoftoj punonjësit e shkollës për gjithçka që mund të prekë shëndetin, sigurinë ose mbarëvajtjen e kolektivit të shkollës;
- t'i mbaj prindërit/kujdestarët e mi të informuar për çështje që kanë lidhje me shkollën dhe t'u dorëzoj çdo material informues që më japin në shkollë për ta çuar në shtëpi;
- t'i ndjek të gjitha rregullat e Kodit Disiplinor;
- të sillem me përgjegjësi, ashtu siç përshkruhet në Deklaratën e të Drejtave dhe Detyrave të Nxënësit.

Kam marrë një kopje të **Kodit Disiplinor** dhe të **Deklaratës të së Drejtave dhe Detyrave të Nxënësit**, dhe e kuptoj këtë kontratë. Pranoj të ndjek rregullat e sjelljes.

Emri i nxënësit: _____ Nënshkrimi: _____ Data: _____
(Lutemi shkruani me shkronja shtypi)

{Pjesa për prindërit}

Kam marrë një kopje të **Kodit Disiplinor** dhe të **Deklaratës të së Drejtave dhe Detyrave të Nxënësit**, dhe e kuptoj se çfarë sjelljeje kërkohet prej fëmijës tim.

Pranoj ta ndihmoj fëmijën t'i përmbahet kësaj marrëveshjeje:

- duke e inkurajuar fëmijën të jetë anëtar i respektueshëm dhe paqësor i kolektivit të shkollës
- duke biseduar me fëmijën për përmbajtjen e Kodit Disiplinor dhe të Deklaratës të së Drejtave dhe Detyrave të Nxënësit
- duke marrë pjesë në çdo diskutim dhe vendim që ka të bëjë me arsimimin e fëmijës tim
- duke marrë pjesë në takimet me prindërit në shkollë
- duke i dhënë shkollës numrat e telefonit dhe informacionin e kontaktit në raste urgjence
- duke e njoftuar shkollën nëse ka ndryshime shqetësuese në shëndetin ose mirëqenien e fëmijës, të tilla që të ndikojnë në aftësitë e tij/saj për të ndjekur mësimet.

Emri i prindit/kujdestarit: _____ Data: _____
(Lutemi shkruani me shkronja shtypi)

Nënshkrimi i prindit/kujdestarit: _____

Kontrata e Sjelljes së Nxënësit (Klasat K – 5)

Emri i nxënësit _____

Datëlindja _____

Klasa _____

E kam të qartë se është e drejta ime:

- të gjendem në një mjedis shkollor të sigurt, të lirë nga diskriminimi, ngacmimi dhe fanatizmi;
- të di se çfarë është sjellja korrekte dhe cilat sjellje mund të bëhen shkas për masa disiplinore;
- të këshillohem nga anëtarët e trupit pedagogjik për sjelljen time dhe ndikimin e saj në ecurinë time në shkollë;
- të mbrohem sipas ligjit në rast të thyerjes së rregullave të shkollës, për të cilat mund të pezullohem ose të dëbohem nga klasa.

Pranoj:

- të vij në shkollë në orar i ndihmuar prej prindërve dhe gati për punë;
- të përdor gjuhë të njerëzishme dhe të mirësjellshme;
- të marr pjesë në takimet klasë/komunitet dhe të shpreh mirënjohje ndaj urtësisë, zemërgjerësisë ose gatishmërisë së dikujt për ndihmë;
- t'i zgjidh konfliktet në rrugë paqësore dhe t'i shpreh ato që ndiej nëpërmjet fjalëve;
- të vishem thjesht, pastër dhe të mos mbaj gjëra të rrezikshme;
- të kujdesem për sendet e mia personale dhe të respektoj sendet personale të të tjerëve;
- t'u tregoj prindërve se çfarë gjërash të reja mësoj në shkollë çdo ditë;
- t'i bëj detyrat çdo ditë dhe t'ua tregoj prindërve/kujdestarëve;
- t'i ndjek rregullat e Kodit Disiplinor.

Këto gjëra i kam biseduar me prindërit dhe pranoj ta respektoj këtë marrëveshje.

Emri i nxënësit: _____ Nënshkrimi: _____ Data: _____
(Lutemi shkruani me shkronja shtypi)

{Pjesa për prindërit}

Kam marrë një kopje të **Kodit Disiplinor** dhe të **Deklaratës të së Drejtave dhe Detyrave të Nxënësit**, dhe e kuptoj se çfarë sjelljeje kërkohet prej fëmijës tim.

E kam të qartë se pjesëmarrja ime në shkollimin e fëmijës do ta ndihmojë të dalë faqebardhë në shkollë. E kam lexuar këtë marrëveshje dhe do t'u dal zot përgjegjësisë të mëposhtme me aq sa mundem.

- Do ta inkurajoj fëmijën të jetë pjesëtar i respektueshëm dhe paqësor i komunitetit shkollor.
- Do të bisedoj me fëmijën për përmbajtjen e Kodit Disiplinor dhe të Deklaratës të së Drejtave dhe Detyrave.
- Do të marr pjesë në takimet me prindërit, programet shkollore dhe veprimtaritë e tjera ku merr pjesë fëmija im.
- Do të bëj çmos që fëmija të vijë në shkollë në orar çdo ditë.
- Do t'i siguroj fëmijës një mjedis të qetë për të bërë detyrat.
- Do të kaloj të paktën 15 minuta në ditë duke lexuar me fëmijën.
- Do ta dëgjoj me vëmendje fëmijën kur ky/kjo të më tregojë se ç'ka bërë në shkollë gjatë ditës.
- Do t'i jap shkollës numrat e telefonit dhe informacionin e kontaktit në raste urgjence.
- Do ta njoftoj shkollën nëse ka ndryshime shqetësuese në shëndetin ose mirëqenien e fëmijës, të tilla që të ndikojnë në aftësitë e tij/saj për të ndjekur mësimet.

Emri i prindit/kujdestarit: _____ Data: _____
(Lutemi shkruani me shkronja shtypi)

Nënshkrimi i prindit/kujdestarit: _____